



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 1 Datë 10. 04. 2017

PËR MIRATIMIN E KËRKESES
“PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE UJORE “

Në mbështetje të nenit 7, nenit 38 “Qëllimet e përdorimit të ujit” gërma c ; nenit 41, “Përdorimi me leje i ujit” gërmat a dhe d ; nenit 50; nenit 51; nenit 52 dhe nenit 53 të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore “ dhe të VKM Nr.416 datë 13.05.2015, “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin - Bunë , miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë :

V E N D O S I :

1-Të miratojë kërkesën e subjektit “AKULL”sh.p.k. me administrator Z.Gjon NIKOLLI për përdorimin e burimit ujor **Hijes së Vasijes** për Linjën e ambalazhimit të ujit në shishe ose enë me vendndodhje në fshatin Qafë Mali, Njësia Administrative Qafë Mali, Bashkia Fushë –Arrëz , Qarku Shkodër .

Vepra e marrjes ka koordinatat: X -44 28 940; Y -46 61 853; Z -780 m;

Prurja mesatare vjetore e burimit është 1.3 l/sek.

Prurja mesatare e muajit më të thatë është 1 l / sek.

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti është 0.0008 m³/sek (0.8 l/sek).

2-Leja e përdorimit të burimit ujor jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3-Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Martin PLLUMBI

KRYETAR

Paulin RADOVANI

